

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“STAKA 2021” SH.P.K.

Sot, më date **27.01.2021**, ne të nënshkruarit:

- **Ermal Staka** lindur me 26/06/1989, shtetas shqiptar, me residence ne Lushnje, mbajtes i leternjofimit nr. **031607699**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- **Namik Staka** lindur me 20/03/1958, shtetas shqiptar, me residence ne Lushnje, mbajtes i leternjofimit nr. **035046546**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**STAKA 2021**” **SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**STAKA 2021**” **SH.P.K.**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja: “Kongresi”, rruga “Riza Kokoshi”, Lushnje, ndertese me sipërfaqje 134 m2 me pasuri nr.129, Zona Kadastrale 3258, qarku Fier.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *stakashpk@yahoo.it*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqërive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- b. Punime marangozi, hidraulike etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.



Neni 5

Kapitali themeltar

- (2) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **5 400 000** (pesemilione katerqindmije) Lekë. Kapitali themeltare perbehet nga:
- 5 000 000 leke kapital ne natyre (ndertese ne pronesi te ortakeve me siperfaqe 134 m2 me vlere 3 000 000 leke dhe linje makineri zdruktarije me vlere 2 000 000 leke) asete te cilat ortaket deklarojne ti kalojne ne sherbim te aktivitetit te shoqerise
 - 400 000 leke kapital ne vlere qe ortaket deklarojne ti vene ne dispozicion te aktivitetit te shoqerise.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Ermal Staka**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **3 240 000** Leke i ndere 3 000 000 leke kapital ne natyre dhe 240 000 lek kapital ne vlere që ne total përbën **60 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Z. Namik Staka** : Zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë te përgjithshme prej **2160000 leke** i ndere 2 000 000 leke kapital ne natyre dhe 160 000 lek kapital ne vlere Leke që ne total përbën **40%** te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.



e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë emerohet Z. **Ermal Staka** lindur me 26/06/1989, shtetas shqiptar, me rezidence ne Lushnje, mbajtes i leternjoftimit nr. **031607699**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjesitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë




Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statuin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Ermal Staka

Ermal Staka


Namik Staka

Namik Staka
